



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.56/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli dhe anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.56/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026, të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.56/2026, nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së nr. 01-1375-2026 të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026. Ankuesi kundërshton ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në pjesën ku mandati i rezervuar për komunitetin serb i është dhënë subjektit politik që përfaqësohet nga z. Nenad Rašić, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e votave që ndikojnë drejtpërdrejt në shpërndarjen përfundimtare të mandateve për këtë subjekt politik janë arritur në mjedise me popullsi dominuese shqiptare, përkatësisht në komunat dhe vendvotimet ku, sipas të dhënave zyrtare demografike dhe fakteve të njohura, praktikisht nuk ekziston ose ekziston një numër i papërfillshëm i anëtarëve të komunitetit serb. Numri i votave të fituara në mjediset ku nuk ka serbë ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e këtij subjekti politik. Parashtruesi i ankesës thekson se sipas rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, subjekti politik që fitoi mandatin e rezervuar për komunitetin serb ka arritur një përqindje të konsiderueshme të votave të tij totale (afërsisht 40%) në mjedise zgjedhore ku komuniteti serb nuk është i pranishëm ose është i pranishëm në një numër statistikisht të papërfillshëm. Subjekti politik i lartpërmendur është regjistruar dhe ka marrë pjesë në zgjedhje si subjekt politik i komunitetit serb për të ushtruar të drejtën për mandate të rezervuara për komunitetin serb, dhe jo si subjekt politik që garon për mandate në kuadër të

shpërndarjes së përgjithshme të vendeve parlamentare. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Kosovës dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese u japin qytetarëve të drejtën e zgjedhjes dhe votimit të lirë, por kjo e drejtë është e kufizuar nga Kushtetuta e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë për përfaqësim adekuat politik, duke mbrojtur njëkohësisht integritetin e procesit demokratik zgjedhor. Ankuesi thekson veçanërisht faktin se subjekti politik "GI – Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", i cili është regjistruar për pjesëmarrje në shpërndarjen e mandateve të rezervuara për komunitetin serb, ka arritur një numër të konsiderueshëm votash në komuna ku sipas rezultateve përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës të vitit 2024, komuniteti serb praktikisht nuk ekziston ose është i përfaqësuar në një numër statistikisht të papërfillshëm. Kështu, në komunën e Mitrovicës së Jugut, ku sipas regjistrimit zyrtar jetojnë vetëm 18 anëtarë të komunitetit serb, ky subjekt politik ka fituar 96 vota. Në komunën e Gjakovës, ku janë regjistruar 17 anëtarë të komunitetit serb, janë fituar 85 vota. Në komunën e Prizrenit, me gjithsej 191 anëtarë të komunitetit serb, janë fituar 443 vota, ndërsa në komunën e Pejës, me 95 anëtarë të regjistruar të komunitetit serb, janë fituar 150 vota. Veçanërisht indikative është fakti se në komunën e Kaçanikut, ku sipas regjistrimit nuk është regjistruar asnjë anëtar i komunitetit serb, subjekti politik në fjalë ka arritur të fitojë vota. Madje edhe këtu duhet të kihet parasysh se edhe pse në komunat e lartpërmendura jeton një numër i caktuar serbësh, subjekti politik i Nenad Rašić nuk i ka fituar votat në vendvotimet ku votojnë serbët, por në vendvotimet ku votojnë anëtarë të komuniteteve të tjera. Kështu për shembull, në komunën e Pejës, 99% e serbëve jetojnë në fshatin Gorazhdec dhe votojnë në qendrën e votimit numër 1719, SHFM "Janko Joviqeviq", ku subjekti politik LQP ka fituar vetëm 7 vota, ndërsa 143 të tjerat në vendvotime ku nuk ka serbë, sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, në veçanti me dispozitat që garantojnë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe përfaqësimin e tyre autentik politik, dhe se një veprim i tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin dhe frymën e garancive kushtetuese që mbrojnë të drejtat politike të komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës. Andaj propozojnë që PZAP-ja ta pranojë ankesën si të bazuar, që të konstatojë se vendimi nr. 01-1375-2026, i datës 27.6.2026, është i paligjshëm sepse është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, standardet ndërkombëtare dhe Kartën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, që t'i udhëzojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë vendim për anulimin e votave të fituara nga subjekti politik "GI – Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" në mjediset me shumicë shqiptare, të cilat ndryshojnë në mënyrë drastike nga numri i serbëve të regjistruar.

KQZ, në përgjigje në ankesë thekson se pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore për subjektin politik që përfaqësohet nga z. Nenad Rašić në komuna të caktuara nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë nuk përbëjnë bazë ligjore për kontestimin e vlefshmërisë së votave apo rezultatit zgjedhor. Një pretendim i tillë nuk mbështetet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë të drejtën e votës dhe administrimin e procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës. Lista e Votuesve (LV) nuk përmban dhe as nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që kanë të bëjnë me etnicitetin e qytetarëve. Po ashtu, Rregullorja Zgjedhore nr.03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës së Votuesve përcakton qartë se (LV) përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative, si emri dhe mbiemri i votuesit, numri personal i identifikimit, data e lindjes, adresa e vendbanimit, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e votuesit dhe ushtrimin e së drejtës së votës, por jo të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të qytetarëve. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë faktike dhe ligjore për të nxjerrë përfundime

ose për të ngritur pretendime lidhur votuesit mbi bazën e përkatësisë së tyre etnike. Për më tepër, neni 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës së Votuesve rregullon procesin e krijimit të LV. Konkretisht, paragrafi 1 i nenit 3 përcakton se: "1. KQZ mban LV-në dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil (RQC), dhe në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia." Po ashtu, paragrafi 3.1 i të njëjtit nen përcakton se: "3.1. Ekstrakti i RQC-së duhet të përmbajë këto të dhëna të votuesve: emrin dhe mbiemrin, numrin personal të identifikimit, datën e lindjes, gjininë, emrin e njërit prind, datën e regjistrimit civil, kodin e qendrës komunale të regjistrimit civil, kodin e komunës dhe emërtimin e komunës, emrin e vendbanimit, adresën, ku përfshihet emri i rrugës dhe numri i hyrjes, si dhe kodet e përdorura të vendbanimeve (P-Code dhe UD-Code), për aq sa është e nevojshme." Ndërkaq, neni 7, paragrafi 4, i së njëjtës Rregullore përcakton se: "4. LV krijohet për secilin vendvotim (VV) dhe përmban këto të dhëna: logon e KQZ, kodin e VV i cili është gjeneruar me barkod, numrin e faqeve, numrin rendor, mbiemrin dhe emrin e votuesit, datën e lindjes së votuesit, si dhe numrin personal të identifikimit, i cili gjithashtu gjenerohet me barkod." Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton qartë se LV përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative të nevojshme për administrimin e procesit zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës së votës. Në asnjë rast nuk përfshihen të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të votuesve. Për rrjedhojë, KQZ nuk ka as kompetencë ligjore dhe as mundësi faktike për të identifikuar, verifikuar apo vlerësuar motivet e votimit ose përkatësinë etnike të votuesve, e rrjedhimisht as për të nxjerrë përfundime mbi baza etnike në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve. Ankesa e palës ankuese lidhur me shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve për një subjekt të caktuar politik nuk është e bazuar dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vlefshmëria ose pavlefshmëria e një fletëvotimi përcaktohet vetëm në bazë të kritereve dhe rasteve të përcaktuara shprehimisht me legjislationin zgjedhor dhe nuk mund të kushtëzohet apo të vlerësohet mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. Rastet kur një fletëvotim shpallet i pavlefshëm janë të përcaktuara në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin i Vendvotimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në Zgjedhjet e Parlamentare për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026, subjekti politik "GI – Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" ka siguruar mandatin e rezervuar për komunitetin serb përmes votave të fituara në komuna dhe vendvotime me shumicë shqiptare, ku komuniteti serb nuk është i pranishëm ose është i pranishëm në numër shumë të vogël dhe se këto vota kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandatit të rezervuar dhe cenojnë qëllimin kushtetues të përfaqësimit autentik të komunitetit serb. Këto pretendime sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë ta pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se “*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr. 03/2026 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Pretendimet e ankuesit mbështeten në analiza statistikore dhe krahasime me të dhënat demografike të komunave, por këto nuk përbëjnë provë juridike për ekzistimin e parregullsive zgjedhore. Vetë fakti që një subjekt politik ka marrë një numër të caktuar votash në komuna me shumicë shqiptare nuk dëshmon se procesi zgjedhor është zhvilluar në kundërshtim me ligjin apo se votat janë të pavlefshme.

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: “*Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhjet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.* Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: “*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.*” Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin KI69/2021, ndër të tjera ka sqaruar se: Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve.

Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në komunat e sipërcituara, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të ankesës të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovë.

Për rrjedhojë, standardet kushtetuese të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese përjashtojnë çdo mundësi që vlefshmëria e votës të lidhet me përkatësinë etnike të votuesit. Çdo pretendim që synon të vlerësojë ose kontestojë rezultatin zgjedhor mbi bazën e përkatësisë etnike të qytetarëve është në kundërshtim me parimet kushtetuese të barazisë, lirisë së votës, fshehtësisë së votimit dhe ushtrimit universal të së drejtës së votës. Gjithashtu, praktika e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se legjitimiteti i votës nuk mund të vihet në dyshim mbi bazën e motiveve, bindjeve apo preferencave të votuesve, ndërsa garancitë kushtetuese për përfaqësimin e komuniteteve nuk mund të interpretohen në mënyrë që të mundësojnë anulimin selektiv të votave mbi baza etnike apo demografike. Paneli konsideron se pranimi i pretendimeve të ankuesit do të nënkuptonte vlerësimin e vlefshmërisë së votës mbi bazën e përkatësisë së supozuar etnike të votuesve ose të strukturës demografike të komunave, gjë që bie ndesh me parimet kushtetuese të barazisë, fshehtësisë së votës, lirisë së votës dhe ushtrimit universal të së drejtës së votës.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetojë se votat për komunitetin serb janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZPAnr.56/2026 më datën 01.07.2026

Kryesues i Panelit

Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



AA.nr.29/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Faton Bajrami dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.56/2026, të datës 01.07.2026, në seancën e mbajtur më datë 06.07.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.56/2026, të datës 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.56/2026, të datës 01.07.2026, është vendosur: Refuzohet e pa bazuar ankesa ZP.Anr.56/2026 e datës 29.06.2026, e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër vendimit të Komisionit Qendror për Zgjedhjeve (KQZ) numër 01/1375/2026 e datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 qershor 2026.

PZAP, në arsyetim të vendimit të lartcekur ndër të tjera ka theksuar se: pretendimet e parashtruesit të ankesës se në Zgjedhjet Parlamentare për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 7 Qershor 2026, subjekti politik “GI – Za Slobodu Pravdu i Opstanak” ka siguruar mandatin e rezervuar për komunitetin serb përmes votave të fituara në Komuna dhe vendvotime me shumicë shqiptare, ku komuniteti serb nuk është i pranishëm ose është i pranishëm në



numër shumë të vogël dhe se këto vota kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandatit të rezervuar dhe cenojnë qëllimin kushtetues të përfaqësimit autentik të komunitetit serb, janë të pa bazuara për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës; të aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet vendimi i PZAP-së numër A.nr.56/2026 i datës 01.07.2026; të anulohet vendimi i KQZ-së 01-1375-2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura me datë 07.06.2026; Të urdhërohet KQZ-ja që të vendos përsëri në përputhje me qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme.

PZAP, ka paraqitur përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar dhe ndër të tjera ka theksuar se: e kundërshtojmë në tërësi ankesën e paraqitur në Gjykatën Supreme, duke shtuar se mbetemi në tërësi pranë vendimit tonë të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime. Tutje, kërkesa për anulim të votave përkatësisht shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në Komunitat përkatës është e pa bazë për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të ankesës të garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.56/2026, nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, paraqitur



kundër vendimit të KQZ-së nr. 01-1375-2026 të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07 Qershor 2026. Ankuesi kundërshton ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në pjesën ku mandati i rezervuar për komunitetin serb i është dhënë subjektit politik që përfaqësohet nga z. Nenad Rašić, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e votave që ndikojnë drejtpërdrejt në shpërndarjen përfundimtare të mandateve për këtë subjekt politik janë arritur në mjedise me popullsi dominuese shqiptare, përkatësisht në komunat dhe vendvotimet ku, sipas të dhënave zyrtare demografike dhe fakteve të njohura, praktikisht nuk ekziston ose ekziston një numër i papërfillshëm i anëtarëve të komunitetit serb. Numri i votave të fituara në mjediset ku nuk ka serbë ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e këtij subjekti politik. Parashtruesi i ankesës thekson se sipas rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, subjekti politik që fitoi mandatin e rezervuar për komunitetin serb ka arritur një përqindje të konsiderueshme të votave të tij totale (afërsisht 40%) në mjedise zgjedhore ku komuniteti serb nuk është i pranishëm ose është i pranishëm në një numër statistikisht të papërfillshëm. Subjekti politik i lartpërmendur është regjistruar dhe ka marrë pjesë në zgjedhje si subjekt politik i komunitetit serb për të ushtruar të drejtën për mandate të rezervuara për komunitetin serb, dhe jo si subjekt politik që garon për mandate në kuadër të 1 shpërndarjes së përgjithshme të vendeve parlamentare.

Në përgjigje në ankesën e ushtruar në PZAP, KQZ ka theksuar se pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore për subjektin politik që përfaqësohet nga z. Nenad Rašić në komuna të caktuara nuk përputhen strukturën demografike të popullsisë nuk përbëjnë bazë ligjore për kontestimin vlefshmërisë së votave apo rezultatit zgjedhor. Një pretendim i tillë nuk mbështetet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë të drejtën e votës dhe administrimin e procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës. Lista e Votuesve (LV) nuk përmban dhe as nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që kanë të bëjnë me etnicitetin e qytetarëve. Po ashtu, Rregullorja Zgjedhore nr.03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës së Votuesve përcakton qartë se (LV) përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative, si emri dhe mbiemri i votuesit, numri personal i identifikimit, data e lindjes, adresa e vendbanimit, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e votuesit dhe ushtrimin e së drejtës së votës, por jo të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të qytetarëve. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë faktike dhe ligjore për të



nxjerrë përfundime 2 ose për të ngritur pretendime lidhur votuesit mbi bazën e përkatësisë së tyre etnike.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë me numër Zp.Anr.56/2026 kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Numër 01/1375-2026 të datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 7 qershor 2026.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i ka vlerësuar të pathemelta dhe të paqëndrueshme, edhe Kolegji i kësaj Gjykate përkrah qëndrimin e PZAP se Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj edhe për Gjykatën këto pretendime janë ta pabazuara duke iu referuar nenit 6 paragrafi 2 i LZP-së, që parasheh se *“Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Edhe Kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, andaj refuzoi ankesën sepse nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin Serb janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara. Madje në vet ankesën subjekti ankues bien ë kundërshtim me vetvetën në dy aspekte: njëri aspekt I referohet faktit se pohon: “subjekti politik ka marrë vota rreth 40 % në mjedise ku nuk ka pjestar të komunitetit sebr ose ka fare pak” kjo përbën kontradiktë sepse nuk ka fare dhe ka fare pak janë dy çështje të ndryshme apo konstatime e madje këto konstatime nuk I provon me prova se qëndrojnë si të tilla dhe kontradikta tjetër qëndron në atë se subjekti politik ndaj të cilit ka pasur ankesë ankuesi që është partia apo subjekti që përfaqësohet nga z. Nenad Rašić që është subjekt politik që përfaqëson komunitetin serb dhe nuk mund të qëndron pretendimin se është cenuar vendi i garantuar sepse cenim të vendit të garantuar do të kishim nëse mandatin do ta merrte apo fitonte një subjekt tjetër jo serb dhe jo subjekti serb. Pra edhe subjekti fitues I një mandate është subjekt që përfaqëson komunitetin serb dhe si I tillë është I regjistruar. Pra ankesa rrjedhimisht me të drejtë është refuzuar nga PZAP-I sikurse refuzohet edhe ankesa ndaj vendimit të PZAP-it nga



Gjykata Supreme sepse subjekti ankues nuk ka arritur të provojë asnjë pretendim ankimor madje sikurse u tha më lartë ka kundërthënë në vet pretendimet ankimore.

Sa i përket pretendimit ankimor të parashtruesit të ankesës së në Mitrovicën e Jugut jetojnë 18 serb sipas regjistrimit, ndërsa janë fituar 96 vota, në Gjakovë ku jetojnë 17 serbë janë fituar 85 vota, e po ashtu në Prizren jetojnë 191 serbë dhe janë fituar 443 vota ... ky fakt nuk përbën manipulim të votave sepse nëse i referohemi Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përkatësisht nenit 6 E drejta për të votuar “1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor.” Nga këto dispozita kuptohet se shtetasi i Republikës së Kosovës me plotësimin e kushteve sipas këtij neni gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, cka nënkupton se ai mund të votojë për cilin do subjekt politik mbi bazën e preferencave të tij vetanake pa u ndikuar nga askush. Madje edhe këto pretendime nuk i ka provuar me prova konkrete, dhe në asnjë mënyrë nuk paraqesin devijim të të drejtë së përfaqësimit apo edhe cenim të vendeve të garantuara. Vendet e garantuara nuk i atribuohen apriori në mënyrë automatike një subjekti ato i atribuohen secilit subjekt garues që përfaqëson komunitetin serbë.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.29/2026 me datë 06.07.2026

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Delašćeni radnik